



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 521, datë 03.11.2021

PËR
NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 315, DATË 22.07.2021

Mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 315 dt. 22.07.2021, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës znj. {...} , në dy periudhat katërmujore Nëntor 2021-Shkurt 2022 dhe Mars 2022 - Qershor 2022, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. Dritan Caka.
2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve {...} e Dritan Caka.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR